

<p><i>Acquis</i> së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare) CELEX : 01991L0676-20081211, DIREKTIVA 91/676/KE TË PARLAMENTIT EUROPIAN DHE TË KËSHILLIT, datë 12 Dhjetor 1991 “Për mbrojtjen e ujrave kundër ndotjes të shkaktuar nga nitratet nga burimet bujqësore” (OJ L 375, 31.12.1991, p. 1)</p>		<p>Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) Projekt Ligj “Për Burimet Ujore” Shkalla e përafritimit (një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur Shkalla e Përafritimit e pjesshme</p>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të <i>acquis</i> së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit.	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.	Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës	Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projektaktit	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafrohet kërkesat e nenit të <i>acquis</i> së BE-së në kolonën e dytë.	Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafritimit për çdo nen të veçantë.	Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafritimit. Kur përafritimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafritimi i plotë.
Neni 2, germa (b)	‘ujëra të freskta/embla’ do të thotë: ujë që rrjedh në mënyrë natyrale që ka një përqendrim të ulët të kripës, i cili është shpesh i pranueshëm për nxjerrje dhe		Neni 3, pika 98	98. “Ujë i ëmbël” është uji që gjendet në mënyrë natyrale dhe ka një përqendrim të ulët të kripërave, i cili shpesh është i përshtatshëm për nxjerrje dhe	E Plotë	

	trajtim për të prodhuar ujë të pishëm;			trajtim për të prodhuar ujë të pijshëm.		
Neni 2, germa (c)	‘përbërës azoti’ do të thotë: cdo substancë që përmban azot me përjashtim të azotit të gaztë molekular;		Neni 3, pika 23	23. “Komponim azoti” është çdo substancë që përmban azot, përveç azotit molekular të gaztë.	E Plotë	
Neni 2, germa (d)	‘bagëti’ do të thotë: të gjitha kafshët e mbajtura për përdorim ose përfitim;		Neni 3, pika 6	6. “Bagëti” janë të gjitha kafshët e mbajtura për përdorim ose fitim.	E Plotë	
Neni 2, germa (e)	‘fertilizues’ do të thotë: cdo substancë që përmban një përbërës azoti ose përbërës azoti të përdorura në tokë për të stimuluar rritjen e perimeve; mund të përfshijë plehun organik të bagëtive, mbetjet nga fermentat e peshqëve dhe llumrat e ujërave të zeza.		Neni 3, pika 51	51. “Pleh” është çdo substancë që përmban një komponim azoti ose disa komponime azoti dhe që përdoret për të ndihmuar rritjen e bimëve dhe mund të përfshijë pleh bagëtish, mbetjet nga fermentat e peshkut dhe llumrat e ujërave të ndotura.	E Plotë	
Neni 2, germa (f)	fertilizues/pleh kimik’ do të thotë: cdo fertilizues i cili prodhohet nga një proces industrial;		Neni 3, pika 53	53. “Pleh kimik” është çdo pleh që prodhohet me një proces industrial.	E Plotë	
Neni 2, germa (g)	‘plehu organik i bagëtive’do të thotë: produktet e mbetjeve të sekretuara nga bagëtitë ose një përzierje e produkteve të mbeturinave dhe mbetjeve të sekretuara nga bagëtitë, edhe në formë të përpunuar;		Neni 3, pika 52	52. “Pleh bagëtish” janë mbetje që ekskretohen nga bagëtitë ose një përzierje e mbeturinave dhe produkteve të mbetjeve që ekskretohen nga bagëtitë, madje edhe në formë të përpunuar.	E Plotë	
Neni 2, germa (h)	‘përdorimi/aplikimi në tokë’ do të thotë: shtimi i materialeve në tokë ose duke i përhapur në sipërfaqen e tokës, injektimi në tokë, vendosja nën sipërfaqen e tokës ose duke i përzier me shtresat e sipërfaqes së tokës;		Neni 3, pika 54	54. “Plehërimi i tokës” është shtimi i materialeve në tokë qoftë duke përhapur në sipërfaqen e tokës, duke injektuar në tokë, duke vendosur nën sipërfaqen e tokës ose duke përzier shtresat sipërfaqësore të tokës.	E Plotë	

Neni 2, germa (i)	‘eutrofikim’ do të thotë: pasurimi i ujit me përbërës ushqyes, komponime azoti që shkakton zhvillim të shtuar të algave dhe llojeve më të larta bimore, që krijojnë prishje të padëshirueshme të barazpeshës së organizmave të pranishme në ujë dhe të cilësisë të këtij uji.		Neni 3, pika 17	17. “Eutrofikim” është pasurimi i ujit me elemente ushqyes, veçanërisht me komponime të fosforit dhe azotit, çka shkakton zhvillim të shtuar të algave dhe llojeve të bimëve ujore, që krijojnë shqetësim të padëshirueshëm të bilancit të organizmave të pranishëm në ujë dhe të cilësisë së ujit në fjalë. Për qëllimet e zbatimit të neneve 111 - 117 të këtij ligji, përkufizimi i termit “eutrofikim” përfshin vetëm komponimet e azotit.	E Plotë	
Neni 2, germa (j)	‘ndotje’do të thotë: shkarkimi i drejtpërdrejtë ose jo, të përbërësve të azotit nga burimet bujqësore në mjedisin ujor, rezultatet e së cilës janë të tilla që shaktojnë rrezik për shëndetin e njeriut, dëmtim për gjallesat e gjalla dhe për ekosistemet ujore, dëmtim të pajisjeve ose interferencë me përdorime të tjera legjitime të ujit;		Neni 3, pika 38	38. “Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, si rezultat i aktivitetit njerëzor, e substancave ose nxehtësisë në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut ose cilësinë e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore që varen drejtpërsëdrejti nga ekosistemet ujore, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësorë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin për mjedisin. Për qëllimet e zbatimit të neneve 111 - 117 të këtij ligji, do të zbatohet përkufizimi i mëposhtëm: “Ndotje” është shkarkimi, në mënyrë të	E Plotë	

				drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i komponimeve të azotit nga burimet bujqësore në mjedisin ujor, rezultatet e të cilave janë të tilla që shkaktojnë rreziqe për shëndetin e njeriut, dëmtim të burimeve jetësore dhe ekosistemeve ujore, si dhe dëmtim të shërbimeve ose ndërhyrje në përdorimet e ligjshme të ujit.		
Neni 2, germa (k)	(k) ‘zona vulnerabël’ do të thotë: një sipërfaqe toke e përcaktuar sipas Nenit 3 (2).		Neni 3, pika 119	119. “Zonë vulnerabël” është një zonë e caktuar toke e përcaktuar nga autoriteti përgjegjës në bashkëpunim me autoritete të tjera, e cila derdhet në ujërat e prekur nga ndotja dhe në ujërat që mund të preken nga ndotja nëse nuk ndërmerren veprimet në zbatim të neneve 114 dhe 115 të këtij ligji, dhe ujërat e të cilave janë identifikuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 111, pika 6 e këtij ligji.	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 2, germa (k) (neni 3(2)) e Direktivës është përafëruar plotësisht nga ky projektligj (neni 111 pika 2 e projektligjit)
Neni 1 dhe neni 3 pika 1	Kjo Direktivë ka si objektiv: - të reduktojë ndotjen e ujit të shaktuar ose nxitur nga nitratat nga burimet bujqësore dhe - të parandalojë këtë ndotje të mëtejshme 1. Ujërat e prekura nga ndotja dhe ujërat të cilat mund		Neni 111, pika 1	1. Me qëllim reduktimin e ndotjes së burimeve ujore, të shkaktuar nga nitratat me origjinë bujqësore, dhe parandalimin e mëtejshëm të kësaj ndotjeje, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore identifikon burimet ujore të ndikuara apo që mund të ndikohen nga ndotja, nëse nuk ndërmerren veprimet në	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 3, pika 1 (neni 5) është transpozuar plotësisht nga referenca e vendosur në nenin 111, pika 1 pjesa e dytë e fjalisë(nenet 114 dhe 115)

	të preken nga ndotja, nëse nuk merren masa në përputhje me Nenin 5, duhet të identifikohen nga Shtetet Anëtare në përputhje me kriteret e përcaktuara në Aneksin I.			zbatim të neneve 114 dhe 115 të këtij ligji.		
Neni 3, pika 2	Shtetet Anëtare, brenda një periudhe dy-vjeçare pas njoftimit të kësaj Direktive, do të përcaktojnë si zona vulnerabël, të gjitha zonat e njohura të tokës në territoret e tyre të cilat kullojnë në ujërat e identifikuar sipas paragrafit 1 dhe të cilat kontribuojnë në ndotjen. Ata do të njoftojnë Komisionin për këtë përcaktim fillestar brenda gjashtë muajve.		Neni 111, pika 2	2. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit shpall si zona vulnerabël të gjitha zonat tokësore në territorin e Republikës së Shqipërisë që drenojnë në burimet ujore të identifikuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni dhe që kontribuojnë në ndotje.	E Plotë	
Neni 3, pika 4	Shtetet Anëtare duhet të shikojnë nëse është e nevojshme një rishikim apo të shtojnë në caktimin e zonave të rrezikuara sipas rastit, dhe në fund të çdo katër viteve, për të marrë parasysh ndryshimet dhe faktorë të paparashikuar në kohën e përcaktimit të kaluar. Ata duhet të njoftojnë Komisionin për çdo rishikim apo plotësim në emërtimet e tyre brenda gjashtë muajve.		Neni 111, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore duhet të rishikojë dhe përditësojë zonat e shpallura vulnerabël sipas nevojës të paktën çdo 4 vjet dhe, duke marrë parasysh ndryshimet dhe faktorët e paparashikueshëm në kohën e shpalljes fillestare. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon informacionin për çdo rishikim apo përditësim lidhur me shpalljen, brenda 6 muajsh nga shpallja e përditësimit.	E Plotë	
Neni 3, pika 5	Shtete Anëtare duhet të përjashtohen nga detyrimi i përcaktimit të zonave vulnerabël specifike, nëse ato krijojnë dhe zbatojnë programet		Neni 111, pika 5	5. Nëse programi apo programet e veprimit të përmendura në pikën 2 të nenit 114 të këtij ligji janë hartuar dhe zbatohen aktualisht për të gjithë	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 3 pika 5 e Direktivës (neni 5), është transpozuar në mënyrë të plotë nga referenca e vendosur në

	e veprimit referuar në Nenin 5 në përputhje me këtë Direktivë në të gjithë territorin e tyre kombëtar.			territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk është i nevojshëm identifikimi i zonave vulnerabël në përputhje me parashikimet e këtij neni.		nenin 111, pika 5 e projektligjit (pika 2, neni 114)
Shtojca I	Kriteret për identifikimin e ujërave referuar në nenin 3(1)		Neni 111, pika 6 dhe 7	6. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, harton kriteret dhe kërkesat për mbrojtjen e ujërave nga nitratat me origjinë bujqësore. 7. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton kriteret dhe kërkesat për mbrojtjen e ujërave nga nitratat me origjinë bujqësore jo më vonë se 9 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.	E Pjesshme	Pika 7 e nenit 111, përcakton bazën ligjore për transpozimin e plotë të shtojcës I
Neni 3, pika 3	3. Kur secili nga ujrat të identifikuar nga një Shtet Anëtar në përputhje me paragrafin 1 janë të prekura nga ndotja prej ujërave nga një Shtet tjetër Anëtar, që kullon drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë në to, Shtetet Anëtare, ujërat e të cilëve janë prekur mund të njoftojnë Shtetet e tjera Anëtare dhe Komisionin për faktet përkatëse. Shtetet Anëtare të interesuara do të organizojnë, kur është e përshtatshme me Komisionin,		Neni 112	Kur ndonjë prej burimeve ujore të identifikuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në përputhje me pikën 1 të nenit 111 të këtij ligji, ndikohet nga burimet ujore të një shteti tjetër që shkarkohen drejtpërdrejt apo tërthorazi në to, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore informon Komisionin e Posaçëm për menaxhimin e Ujërave Ndërkufitarë që të njoftojë shtetin përkatës për këtë fakt, duke i kërkuar ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta për identifikimin e burimeve të ndotjes në fjalë dhe masave për	E Plotë	

	konsultimet e nevojshme për të identifikuar burimet në fjalë dhe masat që duhen ndërmarrë për të mbrojtur ujërat që janë të prekur në mënyrë që të sigurojnë përputhshmërinë me këtë Direktivë.			mbrojtjen e burimeve ujore të prekura.		
Neni 4, pika 1, germa (a)	Me qëllim që të sigurohet për të gjithë ujërat një nivel i përgjithshëm i mbrojtjes kundër ndotjes, Shtetet Anëtare, brenda një periudhe dy vjecare pas njoftimit të kësaj Direktive, duhet: (a) të krijojnë një kod ose kode të praktikave të mira bujqësore, që të implementohen nga fermerët vullnetarish, të cilat duhet të përmbajnë dispozitat që të paktën mbulojnë produktet e përmëndura në Aneksin II A;		Neni 113, pika 1, germa (a)	1. Ministria përgjegjëse për bujqësinë, me qëllim parashikimin e nivelit të përgjithshëm të mbrojtjes kundër ndotjes për të gjitha burimet ujore, brenda 2 vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji: a) harton kodin apo kodet e praktikave të mira bujqësore, që do të zbatohen nga fermerët në mënyrë vullnetare;	E Plotë	
Neni 4, pika 1, germa (b)	(b) ku është e nevojshme të krijojnë një program, duke përfshirë dispozitat e trajnimit dhe informimit të fermerëve, duke promovuar zbatimin e kodit/kodeve të praktikave të mira bujqësore.		Neni 113, pika 1, germa (b)	b) krijon, kur është e nevojshme, një program që përfshin ofrimin e trajnimeve dhe informacioneve për fermerët, promovimin e zbatimit të kodit apo kodeve të praktikave të mira bujqësore.	E plotë	
Shtojca II	Kodi/kodet e praktiva te mira bujqesore		Neni 113, pika 2 dhe 3	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, përcaktojnë elementet minimalë që duhet të përmbajë kodi i praktikave të mira bujqësore.	E pjesshme	Pika 3 e nenit 113 vendos bazën ligjore për transpozimin e plotë të shtojcës II.

				3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kyeministrit, miraton elementet minimalë të përcaktuar sipas pikës 2, të këtij neni, brenda 9 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.		
Neni 5, pika 1	Brenda një periudhe dy vjecare pas përcaktimit fillestar referuar në Nenin 3(2) ose brenda një viti të cdo përcaktimi plotësues referuar në Nenin 3(4), Shtetet Anëtare, me qëllim të realizimit të objektivave të specifikuar në Nenin 1, mund të krijojnë programe veprimi në lidhje me zonat e përcaktuara vulerabël.		Neni 114, pika 1	1. Me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara në pikën 1 të nenit 111 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, harton dhe publikon programet e veprimit lidhur me zonat e shpallura vulerabël: a) brenda një periudhe prej 2 vjetësh pas shpalljes fillestare të zonave vulerabël, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 111 të këtij ligji; ose b) brenda 1 viti nga secila shpallje, në përputhje me pikën 4 të nenit 111 të këtij ligji.	E Plotë	Referencat e vendosura në nenin 5, pika 1 e Direktivës (neni 3(2) dhe nenin 3(4)) janë transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 111 pikat 1, 2, 4)
Neni 5, pika 2	Një program veprimi mund të ketë lidhje me të gjitha zonat vulerabël në territorin e një Shteti Anëtar ose kur një Shtet Anëtar e konsideron të arsyeshme, mund të krijohen programe të ndryshme për zona vulerabël të ndryshme ose pjesë të zonave.		Neni 114, pika 2	2. Programi i veprimit i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të lidhet me të gjitha zonat vulerabël në territorin e Shqipërisë, ose, kur është e përshtatshme, mund të hartohen programe të ndryshme për zona të ndryshme vulerabël apo pjesë të ndryshme të këtyre zonave.	E Plotë	
Neni 5, pika 3, germa (a)	Progamet e veprimit duhet të marrin parasysh:		Neni 114, pika 3, germa (a)	3. Programi i veprimit i përmendur në pikën 1 të këtij neni merr parasysh:	E Plotë	

	(a) të dhënat shkencore dhe teknike në dipozicion, kryesisht duke i'u referuar kontributeve përkatëse të azotit që e kanë origjinën nga burimet bujqësore ose të tjera;			a) të dhënat e disponueshme shkencore dhe teknike, kryesisht lidhur me kontributin e azotit në ndotje, me origjinë bujqësore apo burime të tjera;		
Neni 5, pika 3, germa (b)	(b) kushtet mjedisore në rajonet përkatëse të Shtetit Anëtar në fjalë.		Neni 114, pika 3, germa (b)	b) kushtet mjedisore në rajonet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.	E plotë	
Shtojca III	Masat qe duhet te perfshihen ne programet e veprimit sic eshte referuar ne nenin 5(4) (a)		Neni 114, pika 4 dhe 5	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, përcaktojnë elementet udhëzues për identifikimin e masave të cilat do të përfshihen në programet e veprimit. 5. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton elementet udhëzues për identifikimin e masave, të përcaktuara sipas pikës 4 të këtij neni, brenda 9 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	E Pjesshme	Pika 5 e nenit 114 vendos bazën ligjore për transpozimin e plotë të shtojcës III
Neni 5, pika 4, germa (a)	4. Programet e veprimit do të implementohen brenda katër viteve nga krijimi i tyre dhe duhet të konsistojnë në masat detyruese të mëposhtme: (a) masat në Aneksin III;		Neni 115, pika 1, germa (a)	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, sigurohen që programet e veprimit të përmendura në nenin 114 të këtij ligji të zbatohen brenda një periudhe 4 vjeçare pas miratimit të tyre dhe të përmbajnë minimalisht:	E Plotë	

				a) masat e përcaktuara në zbatim të pikës 5 të nenit 114 të këtij ligji;		
Neni 5, pika 4, germa (b)	(b) ato masa që kanë përshkruar Shtetet Anëtare në kodin/kodet e praktikave të mira bujqësore në përputhje me Nenin 4, me përjashtim të atyre të cilat janë zëvendësuar nga masat e Aneksit III.		Neni 115, pika 1, germa (b)	b) masat e përcaktuara në zbatim të pikës 3 të nenit 113 të këtij ligji, përveç atyre që janë përcaktuar në përputhje me nenin 129 të këtij ligji.	E plotë	
Neni 5, pika 5	Për më tepër Shtetet Anëtare, në kuadrin e programeve të veprimit, duhet të marrin disa masa plotësuese ose veprime përforcuese kur e konsiderojnë të arsyeshme, nëse në dritën e eksperiencës së fitur në implemenitmin e programeve të veprimit, bëhet e dukshme që masat e referuara në paragrafin 4 nuk do të jenë të mjaftueshme për arritjen e objektivave të specifikuara në Nenin 1. Në përzgjedhjen e këtyre masave ose veprimeve, Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh efektivitetin e tyre dhe kostot e tyre përkatëse ndaj masave të tjera parandaluese të mundshme.		Neni 115, pika 2 dhe 3	2. Në kuadër të programeve të veprimit të përmendura në nenin 114 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, sigurohen që të merren të gjitha masat shtesë kur është e nevojshme, në fillim ose gjatë zbatimit të programeve të veprimit, duke argumentuar se masat e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni janë të pamjaftueshme për arritjen e objektivit të përmendur në pikën 1 të nenit 111 të këtij ligji. 3. Gjatë përcaktimit të këtyre masave apo veprimeve, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe ministria përgjegjëse për bujqësinë marrin parasysh efikasitetin dhe koston e tyre krahasuar me masa të tjera të mundshme parandaluese.	E Plotë	
Neni 5, pika 6	Shtetet Anëtare duhet të hartojnë dhe implementojnë		Neni 116	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim	E Plotë	

	<p>programe monitorimi të përshtatshme për të vlerësuar efektivitetin e programeve të veprimit në përputhje me këtë Nen. Shtetet Anëtare të cilat zbatojnë Nenin 5 në të gjithë territorin e tyre kombëtar duhet të monitorojnë përmbajtjen e azotit të ujërave (ujërave sipërfqësore dhe nëntokësore) në pika matëse të përzgjedhura të cilat bëjnë të mundur për të përcaktuar shtrirjen e ndotjes së nitratisë në ujëra nga burimet bujqësore.</p>			<p>me institucionet përgjegjëse për monitorimin e mjedisit dhe ujërave nëntokësore, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e programeve të përshtatshme të monitorimit që ndihmojnë për vlerësimin e efikasitetit të programeve të veprimit të hartuara sipas nenit 114 të këtij ligji.</p> <p>2. Nëse një program veprimi i përmendur në pikën 2 të nenit 114 të këtij ligji lidhet me të gjitha zonat vulnerabël në territorin e Shqipërisë, institucionet përgjegjëse për monitorimin e mjedisit dhe ujërave nëntokësore monitorojnë përmbajtjen e nitrateve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në pikat e përzgjedhura të matjes, të cilat mundësojnë përcaktimin e normës së ndotjes së ujërave nga nitratisë me origjinë bujqësore.</p>		
<p>Neni 6, pika 1 germa (a)</p>	<p>1. Me qëllim të përcaktimit dhe rishikimit të përcaktimit/emërimit të zonave vulnerabël, Shtetet Anëtare duhet:</p> <p>(a) brenda dy viteve nga njoftimi i Direktivës, të monitorojnë përqëndrimin e nitratisë në ujërat e pastra për një periudhë prej një viti.</p>		<p>Neni 117, germa (a)</p>	<p>1. Për qëllimet e shpalljes dhe rishikimit të shpalljes së zonave vulnerabël, të identifikuar në përputhje me nenin 111 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për monitorimin e mjedisit dhe ujërave nëntokësore sigurojnë:</p> <p>a) monitorimin e përqëndrimeve të nitrateve në</p>	<p>E Plotë</p>	

	<p>(i) në stacionet e marrjes së mostrave të ujit sipërfqësor, përcaktuar në Nenin 5(4) të Direktivës 75/440/KE dhe/ose në stacione të tjera të marrjes së mostrave të cilat janë përfaqësuese të ujërave sipërfqësore të Shteteve Anëtare, të paktën cdo muaj dhe më shpesh gjatë periudhave të përmbytjeve;</p> <p>(ii) në stacionet e marrjes së mostrave të cilat janë përfaqësuese të mbajtësve(akuifer) të ujërave nëntokësore të Shteteve Anëtare, në intervale të rregullta dhe duke marrë parasysh dispozitat e Direktivës 80/778/KEE;</p>			ujërat e ëmbla për një periudhë 1 vjeçare;		
Neni 6, pika 1 germa (b)	(b) të përsëritet programi i monitorimit i përshkruar në (a) të paktën cdo katër vjet, me përjashtim për ato stacione të marrjes së mostrave ku përqëndrimet e nitratit në të gjitha mostrat e mëparshme ka qënë nën 25mg/l dhe nuk është shfaqur asnjë faktor i ri që mund të rrisë përmbajtjen e azotit, në rastin e të cilit programi i monitorimit duhet të përsëritet vetëm cdo tetë vjet;		Neni 117, germa (b)	b) përsëritjen e programit të monitorimit të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike të paktën cdo 4 vjet, përveç atyre stacioneve të kampionimit ku përqëndrimet e nitrateve në të gjitha kampionet e mëparshme kanë qënë nën 25 mg/l dhe nuk ka dalë asnjë faktor i ri që mund të rrisë përmbajtjen e nitrateve, rast ky për të cilin programi i monitorimit duhet përsëritur vetëm një herë në 8 vjet;	E plotë	
	(c) rishikimi i gjëndjes eutrofike të ujërave të pastra			c) shqyrtimin e gjëndjes eutrofike të ujërave të ëmbla	E plotë	

	sipërfqësore të tyre, ujrave të rezervuarëve dhe ato detare cdo katër vjet.			sipërfaqësorë, estuariale dhe bregdetare të Shqipërisë çdo 4 vjet.		
	2. Do të përdoren metodat e referencës për matjet e përcaktuara në Aneksin IV.			<p>2. Për qëllimet e matjeve në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për monitorimin e mjedisit dhe ujërave nëntokësorë përcakton metodat referencë të matjeve.</p> <p>3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton metodat referencë të përcaktuara sipas pikës 2 të këtij neni, brenda 9 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p>	E pjesshme	Pika 3 e nenit 117 përcakton bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor përmes së cilit do të transpozohet plotësisht Shtojca VI